
ARCHIVAL POST

# Hafiz Musa Dërguti (1888 - 1961)




SECTION


Clergy

PERIOD

1944 - 1944

# Media 1

MEDIA ITEMS #1



Zotrinj Gjyqtare.

Ne mbeledhjen t'usj sekrete ju do te merrni nje e nga nje kata kriminale per te peshuare aktivitetin dhe fajin e se cilit,dhe per te dhene denimin e merituare.Sigurisht juve qe do te vendosni per denimin e se cilit do t'a shifni fajin e se cilit ne denim qe ka bere,ne rrethanat mentalitetin,rrezikeshmenin shoqnore atjera;por nen harrimi se edhe ata qe mund te duken se kane bere me pak faj,dhe ata kane tradhetuare Atdheun dhe popullin,kane tradhetuare Republiken Popullore.

Populli ka drejtuare syte nga ju Zotrinj gjyqtare,dhe pret me besim te plote denimin e merituare per kata qe kane bere tradhetin me te shentuare.

Ne cilesin t'eme si Prokuror i Popullit kerkoj:

Te cilesohen fajtore ne baze te nenieve 2a 3 ipka:1,2,7,8,9,10, 13 e 14 te Ligjes Nr.372 mbi fajte kundra Shtetit dhe Popullit dhe ne baze te menit 4 po te kesaj ligje kerkoj denimin e tyre si vijon:

1)Per te pandehurit:1)Dalo Kalin, Ensinjor Volaj,Bilbil Hajnin, Xhelal Hordollin,Cin Serreqin,Kakip Beten,Osman Haxhin,Shaban Abdullahim dhe Isa Beten me VDEKJE.

2)Per te pandehurit:1)Fadre Gurashin,Abas Kysin,Myrto Danin, Jakup Danin me BURGIM TE PERJETSHEM.

3)Per te pandehurit:1)Durja Anamali,Nuh Duli me nga 20 vjet privim lirie e pune te detyruare.

4)Per te pandehurit:1)Sami Nepishti,Hafis Derguti,Sulo Kurti dhe Hajdar Tafa me nga 20 vjet privim lirie e pune te detyruare.

5) Per te pandehurin Tom Paloka me 10 vjet privim lriee e pune te detyruare.

6)Per te pandehurit Abas Sulejmanin dhe Taf Kysenjin me nga 5 vjet privim lirie e pune te detyruare.

Gjithashtu kerkoj te vendosat edhe konfiskimi pasunise se tyre te tundeshme dhe te patundeshme.

PROKUROR USHTARAK I Z.U.SH.
Kapiten II.te
(Hasik Ismaili)

Shkodre,me 25/XI/947

## INFORMATION


No additional information is available for this media.

## TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

# Media 2

MEDIA ITEMS #1



I panëshuni i prenon në përgjithsi akuzat qi i bahen ,porse mohon posaçerisht qi të ket marrë pjesë aj vetë ose qi të ket nxitë tjerët me marrë pjesë në sulmin e Llesh Harashit.

"rreth përpjekjes së 9 Shtatorit,pjesmarrja e të panëshunit Jakup i referohet në tëper fazes së funeit të përgatitjes për këtë sulm. Gjithashtu i panëshuni vetënon se edhe në mbështjen e sitës së funeit ,ku morë pjesë vetëm mbassi shkuene me e thirrë në shpi ,nuk u siftue i nxehët dhe entuziast për këtë aventurë ,porse simbas thanjsvet të tija u munue edhe me frenue vrullin e gabuem të shokvet të tjerë. Ma vonë ryma e të tjervet e muer edhe këtë,porse edhe simbas spjegimtarit Avzullah Haiti i panëshuni naten e sulmit nuk ishte i armatosun. I panëshuni Kup Dani ,po të ishte nji nga iniejatorët e sulmit mbi Shkodër ,do të na u paraqitete na sirë i përgatitun për këtë aventurë.

I panëshuni vertetë se mbasi ngjarjes u arratis për pak ditë ,porse me nji herë me datën 27 Shtatuer 1946 ju dorsue Kap. Fadil Kapisyzit.

Akti i dorsimit vullnetarë duhet të konsiderohet si nji shkak lehtesues specifik ligjuer në rastin e caktimit të dënimit për të panëshunit Kup Dani. Gjithashtu edhe fakti se përpara gjyqit u siftue i pranuem për fajin e vet, dhe e dënoj veprimtarin e tija, duhet të këtë peshën e vet në masën e dënimit që do ti caktohet.

I panëshuni Hafiz Musa Derguti - akuzohet se ka prenue me kënaqesi okupimin e vendit nga ky okupatorët fashistë,dhe se ka bashkpunue gjatë luftës luftës me to,se është lidhur me Riza Danin, dhe ka punuar me ato propaganda për përgatitjen e 9 Shtatorit ,dhe me [illegible] ka ahkue neer katunde etj.

Këto akuza i panëshuni i prenon pjesërisht. Porse sido qoftë, Hafiz Derguti nuk ka luajtë ndoi rrol me rastin e përgatitjen e 9 Shtatorit. Gjithashtu nuk u dallue as për aktivitetin as për iniciativen e tijë.

Pjesmarrja e Hafiz Musa Dergutit në ato akte që i atribuohen në akuzë nuk arrit në nji rendësi të veçantë për,mbasi qëndrimi që lidhet me aktet e fajshme na paraqitet i shkëlqyeshëm,p.sh. pavarësisht nga fakti nese mos takimi i datës me Riza Danin rrjedh nga vullneti i tijë ose jo, fakti është se kjo takim ,ku muna të shtrojnë bisedime konkrete nuk ngjau.

Ma në fund edhe pjesa tjetër mbase e takimeve dhe të bashkëjalimeve me të tjerë ,siç thotë i panëshuni na paraqiten të rastësishme, si një dalje nga nji dasmë, ose me [illegible] rrugës,dhe jo me qëllim më vetë.

Gjithashtu edhe mungesa e fuqis së iniejativës, gresa e kulturës, mosha dhe sa rrethana tjera na bajnë me mendue se rroli i luajtun nga i panëshuni Hafiz Derguti kje i dorës së dytë dhe pa rendsi.

Prandej lutena që gjykata në caktimin e masës së ndëshkimit për të ti marrin para syesh të gjitha ato rrethana ,si dhe arsyenet e treguesa në pjesën e parë të këtyjë mendjtje ,dhe ta ëftojnë klemencën e vet në caktimin e dënimit për të panëshunin Hafiz Musa Derguti.

I panëshuni Sulo Kurti - akuzohet se gjatë okupacionit ka pengue rezistencën e popullit duaj u lidhë me krenë reaksionarë, se mbas Çlirimit ështe lidhë me Sulo Kalin duaj është për përgatitjen e 9 Shtat. dhe se ka propagandue në favor të saj. etj.

Sulo Kurti pohon se ka pasë dijeni për këtë levizje,porse ne ato tjeter nuk u vu në dukje ndoi aktivitet i posaçem i tijë në lidhje me këtë. I panëshuni nuk nxiti kurë për të marrë pjesë në këtë levizje. Si njeri i pa shkolluë dhe prapanik ra ra tëper viktimë e të tjervet ,viktimë e nejerzvet që ky ense i besonte dhe i mante ma të urtë se vetin,dhe që ushtrojshin ense një far influence mbi të. Këto çeshtje me e përcaktue si vegel për qëllimet e veta,dhe ky pjesërisht i prenoj këto qëllime ,porse nuk [illegible] bine plotesisht vullnetit të tyne,sepse

INFORMATION


No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.

# Media 3

MEDIA ITEMS #1



Vdekje Fashizmit Liri Popullit

Shtes Proçesi Hafis Musa Dergutit

Per arsye se Musa Derguti nuk pranon që tiket folur Kadri Metit për Sulmin që ju be Shkodrës në daten 9/XI/46 u pa nevoja ballafaqimit dhe u th me daten 24/11/46,Kadri Meti dhe u ballafaqua me Hafis Musa Dergutin ku dek laron nder sy të tij sa ma poshtë vijon. - - - - - - - - - - - - - - - - - -

P.P.Hafis Musa Dergutin e njof tash dy vjet ,na kemi patur nji grindje me Muharrem Seitim ky ka ardhur me na rregullue.Në vereme e kaluar Musa Dergut ka pasë qitë fëmijt e vëllaut tija në Muriq në katundin t'onë. - - - - - - - -

P.P.Hafis Derguti ka ardhë disa herë atje une e kam par dy her një her jem pa në shtëpin e Seit Beqos e gjeta atje mbasi kisha shku për të mbledhur Rinin do vejshe në nji katund tjetër.Hafizi na foli atje çeshtje Partinash duke thenur që këjo qeveri do të ndryshojë do të vijë tjetër qeveri edhe Riza Dani bile më tha mua që ka qenur andej edhe është kthyer .- - - - - -

P.P.Të Diel në mengjes heret dat 8/9/46 që naten u ba çeshtje e Shkodrës Hafis Derguti erdhi atje mbasi na kishin vdekur disa fëmij per ngushllim me u pjekë une kishe vaditur gjith naten nji boatan dhe në mengjes më kish zenur gjumi,kur vjen hoxha grueja e ime vjen në dhomen tjetër dhe më çon duke thenur çou se ka ardhë një hoxhë që rri në shtëpi të Ramadanit dhe une u çova shkova në dhomë tjetër aty gjeta hoxhen ,i fola osh gjelden si je si shkon edhe ky më tha fjalët e tija pastaj më ngushlloi për fëmijët që na kishin vdekur.Më tht skam kohë me ndenjë shum mbasi due me u nis heret mbasi do marr familjen sot.Por më thotë mua tash more djalë ka ardhur puna me të janë ba Shkodra e Malet vllazen janë bashku të tan dhe do ti biem ta zhdukim këte qeveri mor hoxhë se mas ta merrni hallkun në qafë,mos kini gaj le se është puna e kryeme mos u beni të marrë.Prandej më tha i gjith populli duhet të jetë i pregatitur e kur ta lajmërojmë na të dalin më supata e kmes kush nuk ka pushkë.Aj që të mos dalë është bashkëpunus me qeverin (Komunista Mbasi Partin Komuniste do ta zhdukim kreit nuk do tu lem rrac as gra as fëmij prandej edhe ata që nuk do të dalin kështu do të pësojnë.Ikemi për të pyetur as Komandant as një Prandej pritni lajmin tonë.- - - - - - - - - - - - -

P.P.Me këto fjalë u ngreh dhe doli nuk piu as kafe nuk na çuan as një la lajmPo të na kish ardhur lajm do kishim dalur por nuk na erdhi një tjetër kur her sjam pjekë ma me Hafis Dergutin këte fjal që them këtu janë të gjitha të thanura nga goja Hafis Musa Dergutit.Shtoj se më k thenur në rradhë të fundit që e kish porositur edhe Riza Dani që kthen tek Kadriu per mua dhe th thuaji që une jam miku i gjithmonshëm i atyre e baj dhe un pjesë në këte çeshtje po të marr dhe Kadrim.Këto fjalë Hafis mi ke thenur ti them këtu e ti them në gjyq.Persa përmban proçesi mbasi mu këndue me ze të nalt pranoj që që janë të gjitha të verteta dhe i vertetoj me gishtin e dorës djathtë. - - -

Dekraruesi (Kadri Meti)

Oficeri Pyetës (Kap.i I-rë Abdyl Hakiu)

SAMPLE

INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.